

VENDIM
Nr. 466, datë 17.7.2024

**PËR KALIMIN TE BASHKIA TIRANË TË NJËSIVE TË BANIMIT NË
NDËRTESA (PALLAT)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te Bashkia Tiranë të 50 (pesëdhjetë) apartamenteve në 1 (një) ndërtesë me njësi banimi (pallat), përkatësisht, sipas listës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lista e inventarit të objekteve të përfunduara në zonën “5 Maji” (të kolauduara)

Nr.	Emërtimi i kontratës	Vlera e objektit sipas Kontratës (ndërtim+montim+projektim)	Vlera e situacionit përfundimtar (ndërtim+montim)	Vlera e studim-projektimit	Vlera e mbikëqyrjes së punimeve	Vlera e kolaudimit të punimeve	Vlera totale	Sipërfaqe totale ndërtimi (m ²)	Sipërfaqe banimi ap. (m ²)	Sipërfaqe e njërive të shërbimit	Sipërfaqja e katit 1	Hapësirë e përbashkët (kati 1 + kati përdhës+kate banimi +kafaz ashensor+ pandus+pasazh)	Ap. 1+1	Ap. 2+1	Ap. 3+1	Total apartamente (nr.)
1	Banesë kolektive, Godina 21	338,995,000.00	332,207,325.00	5,500,000.00	3,034,128.05	110,000.00	340,851,453.05	7,526.06	4,267.85	890.94	1,310.46	1,056.81	15	30	5	50